



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:269590
Datë: 11.10.2024
Numri i dokumentit: 06288120

C-IV.-14-6946

Ankuesi:

F D në emër të F D nga Prishtina.

Kundër:

E paditura:

N.SH “Gërmia”, të cilën e përfaqëson **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.01 tetor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1.REFUZOHET si e pa bazuar ankesa dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN093-0586 i dt.04 qershor 2014.

2.Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.06 nëntor 2014, ankuesi ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr. PRN093-0586 i dt.04 qershor 2014, me të cilin ka kërkuar kompensim për mjete të asistencës sociale në shumë prej 1,575.00€ nga NSH “Gërmia” (në likuidim). Ankuesi ka deklaruar se ankesën e paraqet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të aplikimit të dispozitave të Ligjit mbi AKP-në. Ka shtuar se vendimi i të paditurës është i gabuar dhe NSH nuk i ka kryer obligimet ndaj punëtorëve nga dt.01.01.2005 deri me dt.14.08.2007 në shumë prej 1,500.75€. Ankesës i ka bashkangjitur: Kopjen e vendimit të atakuar, Formular i kërkesës për likuidim, Vendim i përkohshëm mbi vazhdimin e asistencës sociale nr.746 dt.16.05.2001.

Gjykata me dt.02 gusht 2024, përmes një urdhri të lëshuar ka kërkuar nga ankuesi që të bëjë dorëzimin e provave shtesë në mbështetje të pretendimeve ankimore, siç është kopja e librezës së punës, kopjen e njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kopja e listës së pagave dhe prova tjera që dëshmojnë se NSH-ja i ka mbetur borxh ankuesit.

Ankuesi i është drejtuar gjykatës me anë të parashtresës së dt.13 gusht 2024, duke bërë dorëzimin e këtyre provave: Listën përfundimtare të punëtorëve të 20%-it, Listën e të ardhurave personale të punëtorëve të rregullte për muajin I të 2007, Lista e punëtorëve në asistencë sociale I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII të 2005 Analiza e asistencës sociale të përfunduar me dt.21.12.2005, Kopja e vendimit nr.249/110 dt.13.04.1991, Formulari i kërkesës për likuidim, Vendim i përkohshëm mbi vazhdimin e asistencës sociale nr.746 dt.16.06.2001, Aktvendim nr.890 dt.20.11.1986, Aktvendim nr.890 dt.01.01.1987.

Me dt.26 gusht 2024, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AKP e kundërshton në tërësi kërkesën e ankuesit, pasi që AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht e që objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit. Vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore dhe nuk ka bazë për ta shfuqizuar. Kërkesa e ankuesit është e parashkruar konform dispozitave ligjore, ashtu që e njëjta është parashkruar tri vite nga momenti kur të njëjtit i ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin. Parashtruesi e pranon në mënyrë indirekte se nuk ka punuar në NSH për periudhën për të cilën kërkon pagën. Ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata me dt.03 shtator 2024 i është drejtuar ankueses me urdhër, përmes të cilit ka kërkuar që të bëjë dorëzimin e kopjes së padisë së nënshkruar nga ana e saj, pasi që e njëjta ishte nënshkruar nga F D. F D i është drejtuar gjykatës përmes parashtresës së dt.16 shtator 2024, duke e njoftuar gjykatën se bashkëshortja e tij F D ka ndërruar jetë në vitin .., por kërkesën për asistencë sociale e ka dorëzuar sa ka qenë e gjallë në vitin 2005, andaj bashkëshorti i saj ka kërkuar zhvillimin e procedurës gjyqësore.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL-së.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesja F D ka qenë punëtore e NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se i takon kompensimi për asistencë sociale nga NSH-ja. Ankuesja së bashku me ankesë dhe parashtrësë ka dorëzuar Kopjen e vendimit të atakuar, Vendim i përkohshëm mbi vazhdimin e asistencës sociale nr.746 dt.16.05.2001, Listën përfundimtare të punëtorëve të 20%-it, Listën e të ardhurave personale të punëtorëve të rregullte për muajin I të 2007, Lista e punëtorëve në asistencë sociale I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII të 2005 Analiza e asistencës sociale të përfunduar me dt.21.12.2005, Kopja e vendimit nr.249/110 dt.13.04.1991, Formular i kërkesës për likuidim, Vendim i përkohshëm mbi vazhdimin e asistencës sociale nr.746 dt.16.06.2001, Aktvendim nr.890 dt.20.11.1986, Aktvendim nr.890 dt.01.01.1987. Ankuesja ka dështuar që të dorëzojnë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij edhe pas parashtrimit të urdhrit nga ana e gjykatës.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesja e ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. Ankuesja do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të saj ankimore, por provat të cilat i ka sjellë nuk e dëshmojnë të drejtën e pretenduar. Ankuesja do të mund të dorëzonte librezën e punës dhe njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, për të dëshmuar se nga kur deri kur kishte ofruar shërbime për NSH. Po ashtu, do të mund të dorëzonte listën e pagave për të dëshmuar pagën që e ka marr nga ndërmarrja si dhe ndonjë dokument që dëshmon se i takon kompensimi për asistencë sociale. Provat të cilat i ka dorëzuar ankuesja, dëshmojnë se e njëjta ka qenë përfituese e asistencës sociale për një kohë të caktuar por nuk dëshmojnë të drejtën për kompensim për asistencë sociale.

Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore me dt.31 korrik 2024.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtarja
Hajrie Shala